VENDIM
Nr. 540, datë 18.6.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 11, DATË 14.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2015, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet "... 2046 veta ...".

2. Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit, bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në ndarjen "(2) Aparati i Kryeministrisë', shtohet nënndarja sipas tabelës bashkëlidhur.

b) Pas ndarjes "(25) Agjencia Telegrafike Shqiptare", shtohen ndarjet "(26) Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor", dhe "(27) Prokuroria e Përgjithshme", sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Në ndarjen "(7), Ministria e Financave", për emërtesën "punonjës shërbimi", te "periudha kohore", fjalët "qershor - gusht", zëvendësohen me "tremujore", dhe te "koha mesatare ditore e punës" fjalët "4 orë/ditë", zëvendësohen me "8 orë/ditë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Emri i Institucionit	Nr. Punonjës	Emërtesa	Koha ditore	Periudhë kohore
(2)Aparati i Kryeministrisë	**1**			
Aparati i Kryeministrise	1	Specialist	6 orë/ditë	qershor - dhjetor
(26)Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqësor	**3**			
Gjykata Administrative e Apelit	2	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	korrik - dhjetor
Gjykata e Rrethit Lezhë	1	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	korrik - dhjetor
(27)Prokuroria e Përgjithshme	**1**			
Prokurioria e Rrethit Sarandë	1	Sanitar	4 orë/ditë	qershor - dhjetor